



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 175

Tiranë – E enjte, 1 tetor 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11744, datë 24.9.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	12321
Dekret i Presidentit nr. 11747, datë 28.9.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	12321
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 338, datë 24.9.2020	Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata..	12321
	Korrigjim gabimi material për njoftimin për rishpalljen (për të tretën herë) të procedurave të aplikimit për plotësimin e vendit vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese “Vakancë e parakohshme”.....	12325



DEKRET
Nr. 11744, datë 24.9.2020

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, germa “c” dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, me propozim edhe të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Fllanza Fejza Osmani (Zeneli)
2. Antonio Giuseppe Perrone
3. Samir Beqir Isufi
4. Besim Beqir Isufi
5. Muhammed Enes Mehmet Zeki Işik
6. Sema Nur Bakir Işik (Yavuz)
7. Astrit Mehmet Shala
8. Skender Mehmet Shala
9. Halim Muhamet Hoti
10. Maria Letizia Francesco (Francesco Antonio) Laporta
11. Afrim Zeqir Hasani
12. Gjeve Beqir Maloku Isufaj (Isufaj)
13. Tao Zhuyuan Xuan
14. Qin Weilin Xue

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11747, datë 28.9.2020

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20

të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tij, personit të mëposhtëm:

Winnful Essua Joseph Cobbina

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 338, datë 24.9.2020

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE TË PROCEDURAVE PËR
DHËNIEN E STATUSIT TË
NËPUNËSIT CIVIL GJYQËSOR,
PUNONJËSVE NË DETYRË NË
GJYKATA

Në mbështetje të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 61, pika 2, shkronja “ë”, 90 dhe 97, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 50 dhe neneve 84–88, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë Gjyqësor:

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Objekt i vendimit është përcaktimi i rregullave për procedurat e dhënies së statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata, me qëllim zbatimin e unifikuar të standardeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Neni 2 Subjektet

1. Subjekte të këtij vendimi janë punonjësit në detyrë në gjykata, sipas kategorizimeve të përcaktuara në shkronjat “ç”, “d”, “dh”, “e”, të pikës 1, të nenit 50, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, konkretisht:

1. kryesekretari;
2. sekretari gjyqësor;
3. nëpunësi i financës dhe buxhetit;

4. nëpunës të tjerë që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, arkivit dhe marrëdhënieve me publikun, me jashtë apo me median.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“**Administrata gjyqësore**” është struktura dhe tërësia e veprimtarive që synojnë organizimin dhe sigurimin e funksionimit të gjykatave.

“**Ligji për pushtetin gjyqësor**” është ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

“**Nëpunës civil gjyqësor**” është personi i cili ushtron funksione administrative publike brenda shërbimit gjyqësor ose administrativ të një gjykate në mbështetje të drejtpërdrejtë të sistemit gjyqësor.

“**Shërbim civil gjyqësor**” është trupa e nëpunësve civilë gjyqësorë, që ushtron funksione administrative publike brenda shërbimit gjyqësor ose administrativ të një gjykate në mbështetje të drejtpërdrejtë të sistemit gjyqësor.

“**Punonjës në detyrë**” janë të gjithë punonjësit që janë punësuar në administratën gjyqësore dhe që do të përfshihen në kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë, në kuptim të nenit 2 të këtij vendimi, duke përfshirë kancelarin, ndihmësin dhe këshilltarin ligjor.

Neni 4 Kriteret

1. Punonjësit në detyrë i jepet statusi i nëpunësit civil gjyqësor, nëse përmbush kriteret e klasifikuara si më poshtë:

- a) të përgjithshme;
 - b) të veçanta.
2. Kriteret e përgjithshme janë:
- a) të jetë shtetas shqiptar;
 - b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
 - ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
 - d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
 - dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit;
3. Kriteret e veçanta janë:
- a) për pozicionin e kryesekretarit:
 - i. të jetë i diplomuar në drejtësi në nivelin “Master profesional” ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;
 - ii. të ketë përvojë profesionale jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë së paku tre vjet përvojë pune si sekretar gjyqësor dhe/ose kryesekretar gjyqësor.
 - b) për pozicionin e sekretarit gjyqësor:
 - a) të jetë diplomuar në drejtësi, të paktën në nivelin “Bachelor”;
 - b) të ketë përvojë prej të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.
 - c) për pozicionin e nëpunësit zbatues/drejtues i buxhetit, punonjësi në detyrë duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të dytë në “Master shkencor” ose të zotërojnë diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion.
 - ç) për pozicionin e nëpunësit/specialistit të financës dhe të buxhetit:
 - i. të jetë i diplomuar në shkenca ekonomike, të paktën në nivelin “Master shkencor” ose të barasvlershëm me të, ose “Master profesional”, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;
 - ii. të ketë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet në fushën e kontabilitetit dhe/ose të menaxhimit të buxhetit.



d) për pozicionet drejtuese si nëpunës civil gjyqësor, në fusha të tjera të shërbimeve administrative të gjykatës:

i. të jetë i diplomuar në drejtësi, ekonomi ose teknologji e informacionit ose shkenca komunikimi /gazetari, ose në fusha të tjera të përshtatshme me përshkrimin e punës, të paktën në nivelin “Master shkencor” ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

ii. të ketë kryer të paktën një vit praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.

dh) për punonjësit në detyrë në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, duhet të plotësohen edhe kushtet e sigurimit, të caktuara me ligj të veçantë, si dhe të jepet pëlqimi për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, të nënshkruar prej punonjësit dhe familjarëve të afërm të tij.

Neni 5

Dosja personale

1. Njësia e burimeve njerëzore në Gjykatë ose punonjësi përgjegjës, i caktuar nga Kancelari, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, njofton punonjësit në detyrë, për dorëzimin dhe përditësimin e të gjithë dokumentacionit që vërteton plotësimin e kriterëve sipas nenit 4 të këtij vendimi.

2. Punonjësi në detyrë plotëson dosjen e tij personale me të dhënat që vërtetojnë kriteret sipas këtij vendimi, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit, sipas pikës 1 të këtij neni, së bashku me të dhënat mbi identitetin, adresën, si dhe të dhënat elektronike të kontaktit, që përdoren për njoftim gjatë procedurës. Punonjësi në detyrë informon Kancelarin dhe personin përgjegjës për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës dhe të të dhënave të kontaktit elektronik. Shkelja e këtij detyrimi i bën të papranueshme pretendimet për pavlefshmërinë e njoftimit.

3. Dokumentet dorëzohen në origjinal ose të njësuar me origjinalin, në përputhje me kriteret ligjore të vlefshmërisë së tyre.

Neni 6

Procedura për dhënien e statusit

1. Njësia e burimeve njerëzore në Gjykatë ose punonjësi përgjegjës, nën mbikëqyrjen e Kancelarit, brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit për plotësimin e dosjes personale, i paraqet Këshillit të Gjykatës listën e plotë të punonjësve në detyrë, së bashku me dosjen përkatëse.

2. Këshilli i Gjykatës, brenda një afatit 45 ditë nga marrja e dokumentacionit të mësipërm, bën verifikimin e plotësimit të kriterëve formale, për të gjithë punonjësit në detyrë, sipas nenit 2 të këtij vendimi. Verifikimi i plotësimit të kriterëve formale bëhet nga Këshilli i Gjykatës, sipas procedurës së parashikuar në nenin 28, të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”.

3. Nëse punonjësi në detyrë nuk plotëson kriteret formale të pozicionit përkatës, Këshilli i Gjykatës i komunikon atij gjetjet dhe i shpjegon të drejtat për t’u dëgjuar, për të paraqitur deklaratat dhe prova të tjera, si dhe për t’u përfaqësuar, duke i caktuar dhe një afat, jo më shumë se 7 ditë, brenda të cilit duhet të përgjigjet me shkrim. Punonjësi në detyrë ka të drejtë të kërkojë dëgjimin e tij nga Këshilli i Gjykatës brenda 3 ditëve nga njoftimi i gjetjes. Këshilli i Gjykatës cakton një seancë dëgjimore nga marrja e njoftimit të kësaj kërkesë.

4. Këshilli i Gjykatës, në përfundim të procedurës, vendos:

a) dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor;

b) mosdhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor.

5. Kancelari i njofton vendimin me shkrim, të arsyetuar, të Këshillit të Gjykatës, të gjithë punonjësve të gjykatës, brenda dy javëve nga data e vendimit të Këshillit të Gjykatës. Vendimi i Këshillit të Gjykatës duhet të përmbajë:

a) pjesën hyrëse, që përmban:

i. përbërjen e Këshillit të Gjykatës;

ii. subjektet sipas nenit 2, të këtij vendimi;

iii. datën e vendimit të Këshillit të Gjykatës;

iv. bazën ligjore;

b) pjesën arsyetuese;

c) dispozitivin që tregon:

i. pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur;

ii. të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit.



Neni 7

Sistemimi në një pozicion tjetër

1. Nëse punonjësi në detyrë nuk plotëson kriteret formale të pozicionit përkatës, Këshilli i Gjykatës vlerëson mundësitë ekzistuese për sistemimin në një pozicion tjetër, brenda administratës së gjykatës, të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale, nëse nuk ka arsye për përfundimin e marrëdhënieve të punës.

2. Sistemimi në një pozicion tjetër brenda administratës së gjykatës bëhet pas përfundimit të të gjithë procedurave për dhënien e statusit. Këshilli i Gjykatës, për sistemimin e punonjësit në një pozicion tjetër mban parasysh dhe vjetërsinë e punës në sistemin gjyqësor.

3. Në rastet kur punonjësi në detyrë, në Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, nuk konfirmohet nga Këshilli përkatës i Gjykatës, bazuar në arsye të përcaktuara në pikën 2, të nenit 86, të ligjit nr. 98/2016, atëherë dosja e punonjësit në detyrë i përcillet Këshillit të Lartë Gjyqësor, në zbatim të parashikimeve të pikës 3, të nenit 86, të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”.

Neni 8

Përfundimi i kontratës së punës

1. Vendimi i Këshillit të Gjykatës për statusin e punonjësit në detyrë si nëpunës civil gjyqësor bëhet përfundimtar, nëse ndaj këtij vendimi nuk ushtrohet ankim brenda afatit të parashikuar. Kontrata e punës i përfundon efektet në datën e fundit të afatit të ankimit.

2. Vendimi për statusin e nëpunësit në detyrë bëhet përfundimtar me vendimin gjyqësor të formës së prerë, në rast se ndaj këtij vendimi ushtrohet ankim. Në rast të njohjes së statusit të nëpunësit civil gjyqësor nga gjykata, kontrata e punës së punonjësit në detyrë përfundon në ditën e njoftimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

3. Punonjësit në detyrë, të cilit nuk i është dhënë statusi i nëpunësit civil gjyqësor, si dhe ankimi i të cilit nuk është njohur, vazhdon të konsiderohet si i punësuar, në përputhje me kontratën e punës, deri në sistemimin tij në një pozicion tjetër, sipas nenit 7.

4. Kontrata e punës e punonjësit në detyrë, i cili nuk plotëson kriteret ligjore dhe profesionale, sipas këtij vendimi për sistemimin në një pozicion tjetër, zgjidhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.

Neni 9

Regjistrimi në Regjistrin Qendror të Personelit

1. Kancelari i paraqet Këshillit të Lartë Gjyqësor, brenda tri javëve, vendimet e Këshillit të Gjykatës në lidhje me statusin e punonjësve në detyrë, informacion nëse është paraqitur ankim brenda afatit kohor dhe informacion të nevojshëm për Regjistrin Qendror të Personelit.

2. Në rastin kur është paraqitur ankim, Këshilli i Lartë Gjyqësor regjistron statusin e nëpunësit në detyrë në administratën gjyqësore, brenda një jave pasi është dhënë vendimi gjyqësor i formës së prerë.

Neni 10

Procedura për dhënien e statusit për nëpunësit civil në detyrë në Gjykatën e Lartë

Rregullimet e parashikuara në këtë vendim, zbatohen edhe për nëpunësit civil në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KRYETARE
Naureda Llagami



KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Njoftimi për rishpalljen (për të tretën herë) të procedurave të aplikimit për plotësimin e vendit vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese “Vakancë e parakohshme”, e cila duhej t'i ishte bashkëlidhur dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11742, datë 24.9.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 171, datë 25 shtator 2020.

NJOFTIM

Nr. 3188/1, datë 24.9.2020

PËR RISHPALLJEN (PËR TË TRETËN HERË) TË PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE “VAKANCË E PARAKOHSHME”

Presidenti i Republikës, pasi u njoh me njoftimin nr. 268 prot., datë 18.9.2020 dhe vendimin nr. 29, datë 16.9.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, administruar me nr. 3188 prot., datë 21.9.2020, **konstatoi se:**

Në përfundim të procedurave të verifikimit të kandidaturave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), për plotësimin e vendit vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese “Vakancë e parakohshme”, e krijuar nga përfundimi përpara kohe i mandatit të ish-gjyqtarit Besnik Imeraj, i shpallur fillimisht për aplikim nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 10723, datë 7.2.2018, dhe rishpallur me dekretin nr. 11291, datë 27.9.2019, rezultoi se në garë për plotësimin e këtij vendi vakant nuk ka kandidatë të kualifikuar me vendim të formës së prerë.

Me përfundimin përpara kohe të mandatit të ish-gjyqtarit Besnik Imeraj, Presidenti i Republikës me **dekretin nr. 10723, datë 7.2.2018**, shpalli procedurën për plotësimin e kësaj vakance.

Nga **15 (pesëmbëdhjetë)** kandidatë që shprehën interesin për konkurrim, në përfundim të procedurave të verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi dhe lejoi kandidimin vetëm për **2 kandidatë**, konkretisht:

1. Zoti Besnik Muçi.
2. Zonja Regleta Panajoti.

Presidenti i Republikës, pasi vlerësoi informacionin dhe njoftimin e përcjellë me

shkresën nr. 530 prot. datë 26.9.2019 nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me **dekretin nr. 11291, datë 27.9.2019**, dekretoi: “*Rishpalljen e procedurës së aplikimit për plotësimin e vendit vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me qëllim plotësimin e “Vakancës së parakohshme”, të krijuar për shkak të përfundimit përpara kohe të mandatit të ish-gjyqtarit, zotit Besnik Imeraj*”.

Pas përfundimit të afatit të rishpalljes për aplikim për këtë vend vakant, rezultoi se shprehën interesin për kandidim edhe **6 aplikantë të tjerë**, përveç **2 (dy) kandidatëve** që vijonin të ishin në garë në atë moment për plotësimin e “Vakancës së parakohshme” në Gjykatën Kushtetuese.

Lista e kandidatëve iu dërgua menjëherë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me shkresën me nr. 3802 prot., **datë 22.10.2019**.

Në përfundim të procedurës së vlerësimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidatëve për këtë vend vakant nuk është lejuar kandidimi për **asnjë nga 8 kandidatët**, që shprehën interes dhe paraqitën kandidaturën, ndërsa për kandidatin e fundit të ngelur në garë të verifikuar nga KED-ja, **zotin Shaqir Hasanaj, vendimi i KED-së për ndalimin nga kandidimi është kundërshtuar në Gjykatën e Apelit Administrativ dhe nuk ka ende një vendim gjyqësor të formës së prerë**.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e datës 16.9.2019, shqyrtoi gjendjen e krijuar për këtë vend vakant dhe me vendimin nr. 29, datë 16.9.2020, vendosi të njoftojë Presidentin e Republikës për të vlerësuar mundësinë e rishpalljes së procedurës së konkurrimit për plotësimin e vendit vakant, “Vakancë e parakohshme”, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të krijuar për shkak të përfundimit përpara afatit të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj. Ky njoftim është administruar në Institucionin e Presidentit të Republikës me nr. 3188 prot., datë 21.9.2020.

Bazuar në këto kushte, ku në garën për kandidim për plotësimin e kësaj vakance nuk ka kandidatë të kualifikuar me vendim të formës së prerë (ndërsa vetëm për kandidatin Shaqir Hasanaj vijon procesi gjyqësor), çka në çdo rast bën që të mos plotësohet numri i domosdoshëm prej 3 (tre) kandidatësh, i parashikuar nga neni 125, pika 1, e Kushtetutës, dhe neni 7/b, pika 4, e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Presidenti i Republikës,



në mbështetje të neneve 93, 125, 127, pikat 1/c, 2, 3, dhe nenit 179, pika 2, të Kushtetutës, neneve 7, pikat 2, 7/a, 7/b, 7/dh, pika 2, 86, pika 4, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi u njoh dhe vlerësoi njoftimin nr. 268 prot., datë 18.9.2020 dhe vendimin nr. 29, datë 16.9.2020, të KED-së, me qëllim ndjekjen pa vonesë të procedurave të kërkuara nga Kushtetuta dhe ligji për plotësimin e kësaj **“Vakance të parakoshme”** në Gjykatën Kushtetuese, në cilësinë e organit të emërtesës, me **dekretin nr. 11742, datë 24.9.2020**, ka miratuar:

- Rishpalljen e procedurës së aplikimit për plotësimin e vendit vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me qëllim plotësimin e **“Vakancës së parakohshme”**, të krijuar për shkak të përfundimit përpara kohe të mandatit të ish-gjyqtarit **Besnik Imeraj**.

Presidenti i Republikës, duke vlerësuar informacionin e përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe ecurinë e procesit për plotësimin e këtij vendi vakant, dhe ripërtëritjen sa më parë të Gjykatës Kushtetuese, fton dhe inkurajon:

Çdo person të interesuar, që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit dhe nenin 7/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi të hapur publik për plotësimin e vendit vakant, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës, këto dokumente:

- kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për vendin vakant të rishpallur;
- jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/*e-mail*);
- fotokopje të kartës së identitetit;
- dokumentacionin shoqërues, nëpërmjet të cilit vërteton përmbushjen e kushteve dhe të kriterëve të përcaktuara në nenin 125, pikat 4 e 5, të Kushtetutës dhe nenit 7/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

- formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe nënshkruar, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Formulari i vetëdeklarimit është i publikuar bashkëlidhur këtij njoftimi në faqen e Institucionit të Presidentit të Republikës;

- formularin e aplikimit të plotësuar “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, formular i cili gjendet i publikuar bashkëlidhur këtij njoftimi në faqen e Institucionit të Presidentit të Republikës.

Afati i paraqitjes së kërkesës për shprehjen e interesit, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm bashkëlidhur është data 14 tetor 2020.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikuesve do të publikohet në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës, si dhe në mjetet e informimit publik.

Lista e aplikuesve dhe dosjet respektive të tyre do t'i përcillen menjëherë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), për vijimin e procedurës së verifikimit dhe të vlerësimit, sipas Kushtetutës dhe ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës do të bëjë transparente ecurinë dhe çdo rezultat të këtij procesi, në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për lehtësinë e të gjithë aplikuesve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, më poshtë gjeni të botuar përmbajtjen e nenit 125, pikat 4 e 5, të Kushtetutës dhe të nenit 7/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për verifikim dhe vlerësim për emërimin si gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.



- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 125

[...] 4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj. [...]

- Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar:

Neni 7/a

Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar, që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, diplomë e nivelit të dytë;
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit nga data e kandidimit;
- c) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati, që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet, në bazë të:

- a) vjetërsisë në profesion;
- b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë;
- c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
- c) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
- d) ecuresë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
- dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

4. Organet e emërtesës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore.

Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese mund të dorëzohen me postë ose drejtpërsëdrejti në zyrën e protokollit të Institucionit të Presidentit, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë, kodi postar 1001.

Sqarim

1. Njëri prej kandidatëve në garë për plotësimin e kësaj vakance, zoti Shaqir Hasanaj, nuk ka ende një vendim të Gjykatës së Apelit Administrativ, për shqyrtimin e vlefshmërisë së vendimit të KED-së për ndalimin nga kandidimi.

2. Në zbatim të nenit 127, pika 3, të Kushtetutës, dhe të nenit 7/dh, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, kandidati që do të propozohet nga KED-ja dhe do të përzgjidhet nga Presidenti i Republikës për t’u emëruar gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, për plotësimin e vakancës së parakohshme të krijuar për shkak të përfundimit përpara kohe të mandatit ish-gjyqtarit Besnik Imeraj, do të qëndrojë në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar.

Tiranë, më 24.9.2020

[Formular Vetëdeklarimi](#)
[Formular – AIDSSH](#)

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë